

Ç'është racizmi dhe diskriminimi ?

Kemi të bëjmë me racizëm kur njerëzit mendojnë se një grup individësh është më i mirë, ose më pak i mirë, se të tjerët, për shkak të pamjes së tyre fizike (ngjyrës së lëkurës), origjinës ose fesë së tyre. Racizmi shfaqet në jetën e përditshme (punë, strehim, fqinjësi, etj.). Ai shprehet në forma të ndryshme (fjalë lënduese, fyerje, sulme, përjashtime, etj.). Racizmi është i ngulitur në shoqërinë dhe institucionet tona. Ai është i lidhur me historinë tonë shumëshekullore.

Ç'është racizmi?

Kemi të bëjmë me racizëm kur njerëzit mendojnë se një grup individësh është më i mirë, ose më pak i mirë, se të tjerët, për shkak të paraqitjes së tyre fizike (ngjyrës së lëkurës), origjinës ose fesë së tyre.

Racizmi është çështje pushteti. Ai përdoret për të dobësuar disa grupe individësh dhe forcuar disa të tjerë.

Racizmi është i pranishëm në shumë fusha të jetës së përditshme, si puna, kërkimi i një banese ose marrëdhëniet me fqinjët.

Racizmi mund të marrë forma të ndryshme: fyerje, sulme dhe përjashtime.

Racizmi nuk është gjithmonë i qëllimshëm ose i ndërgjegjshëm. Ai është i ngulitur në shoqërinë tonë, në institucionet dhe zakonet tona shoqërore. Për shembull, racizmi kundër njerëzve me ngjyrë vjen nga historia jonë me kolonializmin dhe skllavërinë.

Diskriminimi

Kemi të bëjmë me diskriminim është kur e trajtojmë një individ ose një grup individësh në mënyrë të padrejtë, për shkak të paraqitjes fizike (ngjyrës së lëkurës), origjinës, fesë, gjinisë, orientimit seksual ose aftësisë së kufizuar.

Kemi të bëjmë me diskriminim racor kur e dëmtojmë dikë, për shkak të paraqitjes së tij fizike (ngjyrës së lëkurës), origjinës ose fesë së tij.

Format e ndryshme të racizmit

- Racizmi ndër-personal (ose racizmi midis individëve): janë paragjykime ose një qëndrim i mbyllur dhe agresiv kundrejt individëve të tjerë për shkak të origjinës ose pamjes së tyre fizike (ngjyrës së lëkurës). Ai mund të shprehet me fjalë lënduese, fyerje, diskriminime ose dhunë.
- Racizmi kulturor: disa kultura nënçmohen ose nuk respektohen, për shkak të stereotipeve raciste. Një stereotip është kur mendojmë “të gjithë afrikanët ose të gjithë aziatikët janë ...”. Stereotipet mund të përforcohen në filma, në art ose në përfaqësime kulturore.
- Racizmi strukturor (ose racizmi në struktura): është kur racizmi dhe pabarazitë janë të pranishme në rregullat dhe organizimin e një shoqërie.

Shumë shpesh, kjo çon në diskriminime, edhe pse askush nuk e do në mënyrë të drejtpërdrejtë.

- Racizmi institucional (ose racizmi në institucione): është kur pabarazitë dhe diskriminimet janë të pranishme në institucione të rëndësishme të shoqërisë, si shkollat ose bota e punës. Racizmi institucional nuk është gjithmonë i dukshëm. Ai është i fshehur. Nga jashtë, nuk shihet asgjë, gjithçka duket normale.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.bonjour-jura.ch/sq/racizmi-dhe-diskriminimi/ceshte-racizmi-dhe-diskriminimi